



## SYLLABUS I LËNDËS “MEKANIZIMI I PYJEVE”

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Mekanizimi i Pyjeve</b>
<b>Programi:</b>	<b>Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative (O)</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>2022/2023</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2 + 2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Do shpallet</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Asoc.Dr. Ylli Kortoci</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<b>E-mail:<a href="mailto:ylli.kortoci@uni-prizren.com">ylli.kortoci@uni-prizren.com</a>; Mob.+38345846817</b>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Ne modulën e Mekanizimit pyjor trajtohen tema të cilat i vijnë në ndihmë përgatitjes së studentëve si teknikien të ardhshëm të mbarështimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe mjedisit në tërësi. Nga temat me të rëndësishme mund të përmendim: Qellimi dhe hyrje në mekanizimin pyjor, e cila trajton nivelet dhe modelet e mekanizimit pyjor në Europë dhe Shqipëri. Në këto tema jepet përkufizimi dhe kuptimi i mekanizimit dhe racionalizimit, si dhe diskutohen premisat, pengesat dhe tendencat e zhvillimit të mekanizimit pyjor. Gjithashtu në këtë modul krijohet mundësia për rifreskimin e njohurive nga fusha teorike si fizika dhe mekanika me përkufizimet, madhësitë dhe njësitë e matjes së rendimentit të makinës. Studentët marrin njohuri të nevojshme për detallet e makinave, lidhjet e tyre dhe motoret me djegie të brendshme. Po në nivelin e duhur ata njohin transmisionet dhe aplikimet e tyre në makineritë dhe mjetet për kryerjen e punimeve pyjore.</p> <p>Me tej studentët marrin njohuri teorike të thelluara për ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e makinave dhe mjeteve për kryerjen e punimeve pyjore, të cilat janë të domosdoshme për rritjen e rendimentit të punës, krijimin e kushteve të përshtatshme për sigurinë dhe shëndetin në punë. Përdorimi i mekanizimit në shkallën e duhur jo vetëm që shton të ardhurat për punetoret por mbron edhe mjedisin pyjor nga dëmtimet. Studentët përgatiten për të qenë të aftë pas mbarimit të shkollës të trajtojnë punetoret për përdorimin e mjeteve dhe makinave pyjore. Në modulën e mekanizimit pyjor trajtohen mjetet e thjeshta si; Leva, Pyka, Karrukulla fikse (Pulexho fikse),</p>

	<p>Karrukulla e levizeshme (Pulexho e levizeshme), Polispastet, Arganellot dhe Plani i pjerret.</p> <p>Po ashtu nje rendesi te veçante i kushtohet teorise se prerjes se drurit dhe perdorimit praktike te mjeteve prerese si motosharra profesionale dhe jo profesionale. Operacionet e heqjes se degeve, heqjes se levores dhe coptimit te lendes drusore trajtohen ne kompleks jo vetem nga ana tekniko-ekonomike por edhe nga ana mjedisore. Per te patur nje nivel te larte te mekanizimit te punimeve pyjore eshte e rendesishme te mekanizojme jo vetem operacionet e prerjes se lendes drusore por edhe ato te transportit te brendshem. Per kete qellim mekanizimi pyjor trajton me perparesi traktoret pyjor te specializuar per kryerjen e punimeve pyjore ( Forwarder, Harvester dhe Procesor) edhe ata te pershtatur si te tille. Traktoret e pershtatur trajtohen bashke me pajisjet e tyre ndihmese per kryerjen e punimeve pyjore si transportin e brendshem dhe ngarkimin e lendes drusore.</p> <p>Pervec operacionit te transportit toksor qe kryhet me traktore dhe paisjeve te tyre mekanizimi pyjor trajton dhe transportin ajror si me miqesori me mjedisin pyjor dhe me gjere. Per kete lloj transporti studjohen me hollesi motoorganot tradicionale dhe mobile apo edhe teleferiket pyjor,. Per keto makineri jepen njohuri jo vetem per ndertimin dhe funksionimin e linjes por edhe per pjeset konstruktive kryesore si litaret e çeliket, pilonat dhe vagonetat, ndrsa helikopteret trajtohen sa per te marr njohuri fillestare lidhur me ta. Mekanizimi pyjor nuk le jashte vemendjes mekanizimin e punimeve ne pyjet e rinj natyror dhe artificial me temat perkatese si: Mekanizmat, mjetet dhe veglat qe perdoren ne rrallimet para-komerciale dhe komerciale, rrallimet ne pyjet natyror dhe artificial, si edhe per mekanizimin e punimeve te pyllzimit me punimin dhe sistemimin e terrenit, hapjen e gropave dhe mbjelljen e fidaneve pyjor. Dhe se fundi mekanizimi i mbrojtjes se pyjeve nga zjarri.</p>
<p><b>Qëllimi i lëndës:</b></p>	<p>Modifikimit të sistemeve tradicionale të punës me sisteme dhe teknika të reja pune;  Përdorimi i energjive të çliruara me kosto të ulët;  Përdorimi i mjeteve komplekse që ndihmojnë në mënyrë të dukshme kryerjen e punës por gjithmonë kjo gjë është e lidhur me rreziqe të mëdha të natyrës fizike, ekologjike dhe ekonomike. Njohja e mjeteve që do të përdoren, si dhe mundësitë, kufizimet dhe sistemet e përdorimit të tyre.</p>



	Vjelja e produkteve drusore të pyllit ose shfrytëzimi i tij, ndërsa sot puna është transferuar duke i kushtuar më shumë vëmendje kultivimit të pyllit për mbrojtjen e tokës nga erozioni, ruajtjen e regjimit ujor dhe në krijimin e funksioneve social – estetike.		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Nepermjet programit të “Mekanizimit Pyjor “ studentet do të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikojnë pjesët perberse të makinave, detalet, transmisionet dhe motoret me djegie të brendshme.</li> <li>2. Peshkruajnë mjetet prerese që përdoren për kryerjen e punimeve pyjore ( motosharren, pjesët perberse dhe funksionimin e saj)</li> <li>3. Zgjedhin mjetet dhe makinat që përdoren në punimet e ndryshme pyjore, si traktoret, motoaganot dhe pajisjet ndihmese të tyre.</li> <li>4. Kategorizojnë makinat dhe sistemet e punës plotësisht të mekanizuara që përdoren në punimet e ndryshme pyjore, si harvester, procesor dhe pajisjet ndihmese të tyre</li> <li>5. Vleresojnë llogaritjen e kostos dhe prodhimtarinë e makinave</li> <li>6. Projektojnë faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e makines pyjore dhe sistemin e punës të zbatuar.</li> </ol>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	1	13	13
Kollokfiime, seminare	2	-	2
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet ,etj	-	-	-
<b>Totali</b>			<b>125 orë (5 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, seminare, projekte të pavarura, kolokviume, detyre kursi, provime.		

<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë (kolokvium): 10%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 10%, Seminaret ose angazhime të tjera: 10%, Provimi final: 70%, Total: 100%.
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura primare:</b>	Mine V. Leksionet Mekanizimi Pyjor (2014) Qendro at al “Mekanizimi i Shfrytezimit Pyjor” (1989). Kortoçi, Y., Kellezi, M. (2012): Shfrytezimi i pyjeve te ahut te Shqiperise me nje silvikulture te qëndrueshme. G. Hippoliti “Mekanizazione Forestale” (Firence 1998). S. Baldini, P. Fabbri “Guida all’uso della motorsega” 1985.
<b>Literatura shitesë:</b>	Haxhi A. Mine V. “Motosharra” 1999. Mine V. “Rrallimet Para – tregtare” 2000. Mine V, Postolo A, Tabaku V. “Rrallimet Tregtare” 2002 Dano K, Mine V. “Puna per ripertertjen e pyjeve” 2004

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Qellimi i mekanizimit pyjor. Hyrje ne mekanizimin pyjor. Kujtese nga fizika e mekanika.	Zbatime praktike te modeleve dhe niveleve te mekanizimit.
<i>Java e dytë:</i>	Detalet e makinave.	Njohja me detalet e makinave dhe lidhjet e tyre.
<i>Java e tretë:</i>	Transmisionet.	Njohja me transmisionet.
<i>Java e katërt:</i>	Motoret me djegie te brendeshme.	Njohja me mekanizmat & sistemet e motoreve me djegie te brendeshme.
<i>Java e pestë:</i>	Motoret me djegie te brendeshme.	Detyre kontrolli.
<i>Java e gjashtë:</i>	Makinat/veglat e thjeshta.	Njohja me mekanizmat & sistemet e motoreve me djegie te brendeshme.
<i>Java e shtatë:</i>	Teoria e prerjes se drurit.	Pjeset perberese te motosharres.
<i>Java e tetë:</i>	Motosharra. Heqja e levores.	Mirembajtja e motosharres. Punim me motosharre.



<i>Java e nëntë:</i>	Makinat coptuese. Makinat kombinat.	Njohja me makinat te heqjes se levores dhe coptuese.
<i>Java e dhjetë:</i>	Traktoret.	Njohja me paisjet ndihmese te traktoreve pyjor. Detyre kontrolli.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Motoargonot.	Ushtrime. Llogaritja e forcese terheqese te makines.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Teleferiket.	Ushtrime. Llogaritja e kapacitetit mbajtes te tamburit. Ushtrime. Llogaritja e forcave te montimit te linje.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Mekanizimi i pyllzimeve.	Ushtrime Llogaritja e pilonave.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Nderhyrjet silvikulturore.	Ushtrime. Llogaritja e varjeve. Detyre kursi.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Makinat për mbrojtjen nga zjarri. Helikopterët.	Ushtrime. Llogaritja e kostos se makinave pyjore. Detyre kontrolli.
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjese ne vizita studimore ne terren(ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësime po ashtu janë obligative.		